



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Kryetarja

Nr. 2969 Prot.

Tiranë, më 03.10.2023

URDHËR
Nr. 53, datë 3.10.2023

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 5.10.2023, ORA 10.00

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve për periudhën 25 shtator – 13 tetor 2023,

URDHËROJ:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancën plenare të datës 5.10.2023, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
 1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 2.10.2023.
 2. Njoftime.
 3. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë””.
 4. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin “Ndërtimi i urave të qëndrueshme, duke përdorur qasjen e programit me shumë faza””.
 5. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2020, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), ratifikuar me ligjin nr. 3/2022”.
 6. Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 34/2022 “Për ngritjen e Nënkomisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat””.
 7. Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin nr. 66/2021 “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e Sekretariateve të Kuvendit”, i ndryshuar”.
 8. Projektvendim “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave Personale në Bazat e të Dhënave Shtetërore”.
 9. Projektvendim “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Kontratat Publike në Sektorin e Shëndetësisë”.
 10. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.
- III. Ngarkohen Shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.
- IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita NIKOLLA





SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 5 tetor 2023, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrorit nr. 53, datë 3.10.2023 të Kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 2.10.2023.

(Neni 44, pika 2 e Rregullores)

2. Njoftime.

(Neni 44, pika 3 e Rregullores)

3. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë””.

(Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

4. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin “Ndërtimi i urave të qëndrueshme, duke përdorur qasjen e programit me shumë faza””.

(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

5. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2020, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), ratifikuar me ligjin nr. 3/2022”.

(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Europiane

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

6. Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 34/2022 “Për ngritjen e Nënkomisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat””. (Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

7. Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin nr. 66/2021 “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e Sekretariateve të Kuvendit”, i ndryshuar”. (Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

8. Projektvendim “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave Personale në Bazat e të Dhënave Shtetërore”. (Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

9. Projektvendim “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Kontratat Publike në Sektorin e Shëndetësisë”. (Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

10. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta)